



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Pro Tech Clean” Sh.P.K. të datës 07.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH” me nr. të prokurimit 616-24-3815-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Pro Tech Clean” Sh.P.K. e datës 07.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH” me nr. të prokurimit 616-24-3815-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Pro Tech Clean” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Pro Tech Clean” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 07.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH” me nr. të prokurimit 616-24-3815-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

**Pretendimi nr. 1** - "Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është më e vogël se sa kërkesat e paraqitura në DT. Pra, ne shkurtimisht po e elaborojmë këtë analizë financiare sipas kërkesave të DT. Pagat e punëtorëve me të gjitha tatimet sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe skemës së ATK-së 76 (punëtorë)\* 400€ (paga bruto) = 30,400€ (bruto) 5% (kontributi i punëdhënësit), 76\*22,13€ është e barabartë 1681,88, pushimet vjetore kapin vlerën prej 2,660.00€, pastaj materiali rreth 1,500.00€, stazhi i punës 850.00€ që është e barabartë 37,091.88€ \* 18% (tvsh) është e barabartë me 43,768.4€, kjo kur të shumezohet me 36 muaj është e barabartë me 1,575.663€. Pra, pa i llogaritur edhe ndërrimet e natës, vikendet dhe festat".

**Pretendimi nr. 2** - "Te kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale keni kërkuar që punëtorëve duhet të ju llogariten edhe ndërrimet e natës, vikendet, festat sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212 si dhe ligjeve tjera që e rregullojnë marrëdhëniet e punës si dhe ATK-në. Kërkojmë nga ju si AK të na jepni numrin e saktë të punëtorëve të cilët punojnë vikendeve, festave dhe ndërrimeve të natës, sepse, ne nuk e dime sa është ky numer për t'i llogaritur saktësisht se për sa punëtorë është fjala. Kur të llogariten edhe ndërrimet e natës, vikendet dhe festat atëherë rritet vlera e lartecur prej 1,575.663€ për këtë projekt, që do të thotë vlera e parashikuar për këtë projekt minimumi duhet të rritet 10 deri në 15%".

Fillimisht duhet sqaruar se pretendimet ankimore i referohen kërkesave të dosjes së tenderit të formuluar si në vijim:

2.OE duhet të deklarohet se do të paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori në BRUTO prej 400.00 euro me të gjitha obligimet ku duhet të llogariten ndërrimet e natës, vikendet, pushimi vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se.	2. a), b)Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE si dhe analizën financiare të detajuar (original).
3. OE duhet të deklarohet se pranon të punësoj 36 punëtor nga lista e AK-se dhe për kryerjen e shërbimeve do të shtoj edhe 40 punëtor nga personeli i tij gjithashtu të deklarohet për pagesën e përvojës së punës për 36 të punësuar vlera e të cilës është 850 (pa TVSH)	3. a) deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE.

Sa i përket pretendimit nr. 1 sipas të cilit vlera e parashikuar nuk është e mjaftueshme për të mbuluar pagat e punëtorëve, duhet cekur se vlera e parashikuar e kontratës është e mjaftueshme për të realizuar në mënyrë efikase dhe efektive kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Kalkulimi që e prezanton parashtruesi në pretendimin nr. 1 është tërësisht i gabuar pasi që anashkalohet pjesa e kërkesës në dosjen e tenderit ku thuhet "BRUTO prej 400.00 euro me të gjitha obligimet ku duhet llogariten ndërrimet e natës, vikendet, pushimi vjetor... (etj)". Prandaj pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit nr. 2 duhet theksuar që në fakt këtu nuk kemi të bëjmë me asnjë pretendim ankimor konkret që dmth se parashtruesi nuk konteston asnjë pjesë të dosjes së tenderit mirëpo vetëm kërkon sqarime sa i përket njërës prej kërkesave të dosjes të cituara si më sipër. Megjithatë afati për të kërkuar sqarime shtesë ka përfunduar ndërsa kërkesa për rishqyrtim si mjet juridik nuk mund të shfrytëzohet për të kompensuar faktin

që parashtruesi nuk ka kërkuar sqarime shtesë brenda afatit të përcaktuar. Pavarësisht kësaj autoriteti kontraktues bën me dije se ndërrimet e natës nuk aplikohen në të gjitha KPSH por vetëm në disa prej tyre. Përndryshe kërkesat e dosjes së tenderit janë jashtëzakonisht të kuptueshme, konkrete dhe të domosdoshme. Mirëpo të njëjtat duhet të lexohen me kujdes për t'u kuptuar dhe me rastin e ofertimit duhet të respektohen në tërësi pa gabime.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 13.05.2024**

  
  
**Visar SHEHU**  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.